



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1394/2 prot

Datë 04.06.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MALBERTEX” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me REF-00724-04-09-2024 me objekt: “*Blerje Uniforma për punonjësit e Portit Detar SHA Sarandë*”, me fond limit 2,167,670 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Porti Detar sh.a Sarandë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “MALBERTEX” SHPK, me NIPT: K71821009N
Adresa: Siri Kodra bll.magazinave, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Porti Detar sh.a Sarandë
Adresa: lagjia nr 4, rruga “Mit'hat Hoxha”, Sarandë.

Në datën 02.06.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4142 dhe me nr. 1394 protokollit datë 03.06.2024 e operatorit ekonomik “MALBERTEX” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me REF-00724-04-09-2024 me objekt: “*Blerje Uniforma për punonjësit e Portit Detar SHA Sarandë*”, me fond limit 2,167,670 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Porti Detar sh.a Sarandë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MALBERTEX” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “MALBERTEX” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1394 prot., datë 03.06.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Oferta ekonomike e paraqitur është anomalisht e ulet referuar Ligjit nr 162, i ndryshuar me Ligjin 16/2024, Neni 93, pika 5”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.06.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri